



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura VI**

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion, Mandate,

Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen

e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 33

Prishtinë, më 03.07.2018, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N/302

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Albulena Haxhiu, Hajdar Beqa, Bahrim Shabani, Frashër Krasniqi, Sami Kurteshi, Arben Gashi, Korab Sejdiu, Nezir Çoçaj, Igor Simić, Shkumbin Demaliaj dhe Bilall Sherifi;

**Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë:** Fitore Sopjani- Praktikante Kuvendi i Kosovës, Ardita Sylejmani RTK, Rreze Hoxha GLPS, Dibran Istrefi Klan Kosova, Paris Guri KDI, Albulena Nuha RTV 21, Besjana Bajrami Ekonomia Online, Berita Abazi LVV, Norë Shabani Koha Ditore, Salih Zyba LVV, Vlorë Tosuni, Marija Maksimoviç, Nita Istrefi dhe Luljeta Aliu Inject NGO, L.Berisha OSCE.

**Mbledhjen e kryesoi,** Albulena Haxhiu-Kryetare e komisionit

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur me datë 15.05.2018;
3. Formimi i Grupit punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr.03/L-101 për Faljen;
4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit;
5. Shqyrtimi i kërkesës për iniciimin e proceduarve për ndryshim plotësimin e Ligjit për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore;
6. Shqyrtimi i kërkesës së Sindikatës së pavarur të ish-Këshillit Komunal për Financim Gjakovë , vitet 1992-1999;
7. Të ndryshme;

## 1. Miratimi i rendit të ditës;

**Kryetarja**, propozoi që Projektligji për plotësim ndryshimin e Ligjit për Familjen të futet si pikë shtesë e rendit të ditës. Ajo tha se qenë nismë e Komisionit për Legjislacion në bazë të kërkesës së Znj. Aliu.

*Propozimi i znj.Haxhiu që Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Familjen të futet në rend të ditës, u përkrahë unanimisht.*

**Hajdar Beqa**, propozoi që pika 3 e rendit të ditës, që ka të bëjë me Formimin i Grupit punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr.03/L-101 për Faljen, të hiqet nga rendi i ditës. Me arsyetimin se ndoshta kjo pike e rendit të ditës duhet të jete në sesionin e ri të kuvendit. Këtij propozimi i'u bashkua edhe deputeti Shkumbin Demaliaj.

*Meqenëse nuk kishte diskutime tjera, kryetarja konstatoi se me **gjashtë vota “për” tre vota “kundër” dhe një “apstenim”** u vendos që pika tre që ka të bëjë me formimin e grupit punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr.03/L-101 për Faljen, të hiqet nga rendi i ditës.*

*Rendi i ditës u miratua me ndryshimet e propozuara.*

## 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur me datë 15.05.2018;

*Meqë nuk kishte vërejtje, Kryetarja konstatoi se miratohet procesverbali nga mbledhja e mbajtur me datë 15.05.2018.*

## 2. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit;

**Kryetarja**, tha se në seancën e kaluar është vendosur që Komisioni të ngarkohet për shqyrtimin e këtij Projektligji dhe me datë 09.07.2018 të jetë shqyrtimi në parim i këtij Projektligji. Pas shumë debateve, është vendosur që komisioni pastaj të vlerësojë se kur të bëhet shqyrtimi i dytë i këtij projektligji, dhe sa kohë do të duhet Komisionit për Legjislacion të punojë në këtë projektligj theksoi deputetja Albulena Haxhiu.

**Hajdar Beqa**, theksoi se në seancë ka pasur një konsensus që shqyrtimi i parë i projektligjit të bëhet me datë 09.07.2018. Propozimi i z. Beqa ishte që pas diskutimit, ky projektligj të kalojë në parim. Poashtu sipas tij dhjetë ditë janë të mjaftueshme për shqyrtimin e dytë, pra shqyrtimi i dytë të bëhet me datë 19.07.2018.

**Bilall Sherifi**, tha se nuk ka rëndësi kur bëhet shqyrtimi i dytë por rëndësi ka që të gjejmë një pajtueshmëri që qoftë edhe seancën e fundit të këtij sesiioni pranveror, ta shqyrtojmë projektligjin.

**Frashër Krasniqi**, sipas z. Krasniqi ky projektligj nuk duhet të shqyrtohet kështu si i tillë që është, aq më pak me këtë shpejtësi.

**Korab Sejdiu**,tha se krejt çka duhet të bëjmë sot është që ta trajtojmë ligjin dhe t'i propozohet seancës që Ligji të kalojë apo mos të kalojë varësisht prej votave, për lexim të parë. Pastaj çka ndodh tutje seanca vendos.

**Kryetarja**,theksoi se në seancën e kalume jemi munduar që të marrim informacione edhe nga Ministri i Drejtësisë por ishte e pamundur që të vij deri tek një përgjigje se cili do të jetë misioni i EULEX-it për arsye që ka kundërthenië ndërmjet Ministrin të Drejtësisë por edhe Këshillit të Evropës dhe Qeverisë. Pra cili do të jetë roli i EULEX-it? Poashtu tha se i ka shkruar Zyrës së Presidencës dhe ka kërkuar letër këmbimin e Presidentit Hashim Thaqi por nuk ka pasur mundësi që ta siguroj. Veç tjerash theksoi mosdijenin se çfarë përmban ajo letër dhe sipas saj kjo është shumë problematike. Deputetja Haxhiu gjithashtu tha se për Vetvendosjen ky projektligj është i papranueshëm edhe në aspektin procedural por edhe në aspektin përmbajtësor.

**Frashër Krasniqi**, tha se para se të votohet ligji duhet të kemi parasysh që privatizimi ka qenë një prej proceseve ma të dëmshme përsa i përket rrënimit ekonomik dhe industrial të Kosovës. Kjo nënkutpon që gjykata ose dhoma e posaçme të cilën po kerkohet t'i vazhdohet mandati është një prej institucioneve më të rëndësishme sa i përket sistemit të drejtësisë dhe sa i përket keqpërdorimeve që janë bërë në privatizim. Sipas z. Krasniqi është e pa arsyeshme që të krijohen mekanizma dhe të miratohen ligje Ad-hoc Poashtu tha se nuk e kupton nevojën pse duhet krijuar një Dhomë e Posaçme për çështjet që kanë të bëjnë me AKP-në. Fakti që të futet në kundër të Gjykatës Supreme dhe e ka Kryetarin e njejtë, e mohon të drejtën e palëve për apelim. Ai tha se mund të krijohet një departament në kuadër të sistemit të drejtësisë i cili merret në mënyrë të veçantë me AKP-në,dhe vendimet e këtij departamenti mund ti apelonit te Gjykata e Apelit, pastaj edhe tek Supremja me mjete të jashtëzakonshme deri në Gjykatë Kushtetuese theksoi deputeti Frashër Krasniqi.

**Sami Kurteshi**, tha ky ligj ka ndryshuar disa herë për arsye të ndryshme. E dimë që asnjë ndërmarrje që është privatizu nuk ka dhënë rezultate. Ky është ligj që mbron krimin e organizuar në privatizimin e pasurisë shoqërore dhe publike në Republikën e Kosovës. Duke thënë se ka vërejtje edhe në përmbajtje ai tha se nuk do ta votoj këtë projektligj.

**Hajdar Beqa**, tha se projektligji për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, përkundrazi i mbron palët, sepse privatizimi edhe ashtu po ndodhë. Deputeti Beqa propozoi që ligji të votohet në parim dhe pastaj plotësim ndryshimet ti japim gjatë dy leximeve.

**Bilall Sherifi**, tha se në këtë ligj ka çka rregullohet por mendoj që ky projektligj është i domosdoshëm. Prandaj ai propozoi që të dërgohet në seancë dhe pastaj secila parti të votoj sipas bindjes së vet.

**Korab Sejdiu**, tha se duhet me ti jepet serioziteti i duhur edhe në trajtim por edhe në gjetjen e mënyrës më të mirë për ta rregulluar këtë organ. Pajtohem me Kryetaren që është e domosdomshme sepse është ngrit edhe në seancën e kalume qasja jonë si deputet në lëter këmbimin që e ka bërë Presidenti. Ky ligj trajton shumë më shumë sesa vetëm çështjen e gjyqtarëve të EULEX-it. Duhet të shikohet mundësia në mes të leximit të parë dhe të dytë se si të gjitha këto ide dhe sygjerime që i kemi të merren parasysh dhe të amendamentohet projektligji. .

**Sami Kurteshi**, tha se ky projektligj është ombrella e ligjit kriminal mbi privatizimin. Me këtë ligj mbulohen veprimet e Agjencionit Kosovar të Privatizimit. Prandaj ky ligj është ndryshuar kaq shpesh për arsye se janë bërë përpjekje të arsyetohen veprimet që kanë ngjarë në Agjencionin Kosovar të Mirëbesimit dhe të Privatizimit. Mendoj se me këtë ligj duhet shumë kujdes sepse me këtë ligj vëmë baza për keqperdorime si ka ngja deri më tani. Unë mendoj që baza e së drejtës çënohet me këtë ligj prandaj unë nuk votoj në parim theksoi deputeti Sami Kurteshi.

**Frashër Krasniqi**, tha se është krijuar pasiguri dhe kaos sa i përket ligjeve dhe amendamentimit të shpesht të ligjeve në Kosovë. Kjo po ndodhë sepse ligjet e rëndësishme vijnë në mënyrë të përsheptume, të jashtëzakonshme. Është e vërtetë që janë miratuar ligje edhe më herët në mënyrë të përsheptume dhe kjo është një prej arsyeve pse i kemi punët kaq keq sot potenco i deputeti Frashër Krasniqi.

**Arben Gashi**, duke parashtruar pyetje tha, ky ligj, ky koncept i ndarjes së drejtësisë a është i duhuri a nuk është i duhuri? A është koncept i cili ka me vendos drejtësi në rast të kontesteve juridike mes palëve apo nuk do te jep drejtësi? Indicia është që nuk jep drejtësi sepse janë 21 mijë e 300 landë për të cilat nuk ka drejtësi që 17 vite. Deputeti Gashi vazhdoi duke thënë se ka edhe dy elemente tjera problematike. Elementi i parë është ndryshimi i vendimarrjes, ndërsa elementi i dytë ka të bëjë me dyshkallshmëri. Unë jam për ekonominë e tregut, jam për privatizimin por mekanizmat e privatizimit duhet të jenë në funksion të ekonomisë dhe të shoqërisë, theksoi deputeti Arben Gashi.

**Sali Zyba**, tha se jam këtu për arsye të qendrimit që ka mbajtur Qeveria, në lidhje me ligjin, përfaqësuesi i Qeverisë, fillimisht ka thënë se kanë filluar një proces të rekrutimit, dhe më pas prej pyetjeve të deputetëve u kuptua që nuk ka filluar procesi i rekrutimit. Këto qendime që i ka mbajtur Qeveria janë problem në raport me ligjin. Nëse ka implikime buxhetore atëherë duhet ta dijnë të gjithë. EULEX-i edhe nëse ka shkuar, nuk mund të amnistohet sepse këto përgjegjësi kanë qenë të EULEX-it, theksoi z. Zyba.

*Pas shumë diskutimeve Kryetarja konstatoi se me katër vota “për” pesë “kundër” dhe një “apstenim” komisioni nxori këtë:*

### **R e k o m a n d i m**

Të mos miratohet në parim, Projektligji nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

### **3. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2004/32 për Familjen i Kosovës;**

**Kryetarja**, paraqiti para komisionit Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/32 për Familjen i Kosovës, dhe meqë nuk kishte diskutime kryetarja konstatoi se komisioni unanimisht nxori këtë:

### **R e k o m a n d i m**

Të miratohet në parim, Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/32 për Familjen i Kosovës.

#### **4. Shqyrtimi i kërkesës për iniciimin e proceduarve për ndryshim plotësimin e Ligjit për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore;**

**Kryetarja** paraqiti para komisionit kërkesën për iniciimin e procedurave për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, dhe kërkoi që anëtarët e komisionit të deklarohen në lidhje me këtë çështje.

*Pas diskutimeve njëzëri u vendos si vijon:*

Komisioni vlerësoi se kjo çështje nuk bie në fushëveprim të Komisionit dhe vendosi që të njëjtën t'ia procedojë Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Mjedis e Planifikim Hapësinor.

#### **5. Shqyrtimi i kërkesës së Sindikatës së pavarur të ish-Këshillit Komunal për Financim Gjakovë , vitet 1992-1999;**

**Kryetarja** paraqiti para komisionit kërkesën, e Sindikatës së pavarur të ish-Këshillit Komunal për Financim Gjakovë, 1992-1999, dhe kërkoi që anëtarët e komisionit të deklarohen në lidhje me këtë çështje.

*Pas diskutimeve njëzëri u vendos si vijon:*

Komisioni vlerësoi se kjo çështje nuk bie në fushëveprim të Komisionit dhe vendosi që të njëjtën t'ia procedojë Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale.

#### **6. Të ndryshme.**

*Në këtë pikë të rendit të ditës nuk kishte diskutime.*

Mbledhja përfundoi në orën 14:26

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

\_\_\_\_\_  
**Albulena Haxhiu**